

Ky hulumtim është dizajnuar dhe ndërmarrë nga Demokraci Plus për të mbledhur pikëpamjet e qytetarëve për performancën e shtatë Gjykatave Themelore të Kosovës.

I bërë për nevoja të Programit të USAID-it për Fuqizim të Sistemit të Drejtësisë (JSSP), hulumtimi ka për qëllim që t'u ofroj informata gjykatave për përmirësim të efikasitetit dhe reputacionit të tyre para qytetarëve.

Rezultatet e hulumtimit mund të shërbejnë si një mjet për matjen e cilësisë së shërbimeve në të shtatë Gjykatat Themelore.

Ky hulumtim i shërben Gjykatave Themelore, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe të gjitha organeve tjera brenda sistemit gjyqësor në Kosovë.

Qëllimi kryesor është identifikimi i zbrazëtirave në tri fusha dhe përmirësimi i efikasitetit dhe informimit më të mirë të shfrytëzuesëve të shërbimeve në gjykata.